



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

EC MA NDRYSHE RAPORT VJETOR I PUNËS 2013

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Rr. Perandori Dioklician 14 (kati V), 10000/Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

PËRMBAJTJE

EC Ma Ndryshe	3
Programet	4
Projektet	6
Shkurtimisht viti 2013	12
Publikimet	20
Rrjetëzimi	22
Donatorët	23

EC MA NDRYSHE

Organizata jo-qeveritare "Emancipimi Civil Ma Ndryshe" u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t'i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma "Culture 2013" (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – Ilogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni "Qytet i kulturës" - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit "Online Trasparenca",: 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit "A Balkan Tale" (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).

PROGRAMET

Që nga themelimi më 2006, EC Ma Ndryshe ka qenë aktivisht e përfshirë në përfundimin e qytetarisë aktive për të ndikuar në politikat publike në nivel lokal (komunën e Prizrenit), me fokus të veçantë në politikat kulturore. Organizata synon arrijtjen e një qytetarie të përgjegjshme në nivel lokal dhe shfrytëzimin e kulturës si mjet të zhvillimit lokal ekonomik. Gjatë vitit 2013, EC Ma Ndryshe ka operuar me dy programe kryesore: pjesëmarrjen qytetare dhe trashëgiminë kulturore. Puna e organizatës fokusohet në tri nivele të veprimit: adresimi i politikave publike, mobilizimi i komunitetit dhe përdorimi i mjeteve të intervenimit direkt për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore. Strategjia e punës së organizatës do të përdorë qasjen trekëndëshe kulturore – pjesëmarrje – zhvillim (burim – mjet – rezultat). Kjo qasje e sheh kulturën si burim për t'u shrytëzuar, pjesëmarrjen si metodë të veprimit, derisa zhvillimin ekonomik si rezultat të dëshiruar.

Programi i Trashëgimisë Kulturore

EC Ma Ndryshe është organizatë e profilizuar në trashëgimi kulturore. Nga themelimi më 2006, organizata është dëshmuar me veprime konkrete në emër të promovimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të Kosovës, me fokus në qytetin e Prizrenit. Si rezultat i performancës së saj, EC Ma Ndryshe përfaqëson Kosovën në rrjetin më të suksesshëm rajonal të trashëgimisë kulturore South East European Heritage Network (www.seeheritage.org). Angazhimi qendror i organizatës në fushën e trashëgimisë kulturore është promovimi i kësaj trashëgimie duke e nxjerrë në pah potencialin zhvillimor të saj.

Linjat programore të komponentës së trashëgimisë kulturore në EC Ma Ndryshe janë:

- promovimi dhe ngritja e vetëdijes për ruajtjen e trashëgimisë kulturore,
- standardet ligjore dhe institucionale të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,
- pjesëmarrja qytetare në bërjen dhe implementimin e politikave kulturore,
- intervenimet direkte me qëllim ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore,
- konservimi i integruar i trashëgimisë kulturore,
- monitorimi i veprimeve institucionale në mbrojtje të trashëgimisë kulturore,
- standardet ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore, dhe
- zhvillimi lokal ekonomik përmes utilizimit të potencialit kulturor (kulturizmi).

EC Ma Ndryshe ka përcaktuar këto objektiva afat-mesme të veprimit të saj në trashëgimi kulturore në komunën e Prizrenit:

- Miratimi i të gjitha akteve ligjore nga Kuvendi Komunal i Prizrenit për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore,
- Integrimi substancial i komponentës së trashëgimisë kulturore në planifikimin e zhvillimit (Plani Zhvillimor Komunal, Plani Zhvillimor Urban dhe Planet Rregulluese Urbane),
- Rritja e kapaciteteve të shoqërisë civile (dhe komunitetit) për veprime direkte në mbrojtje të trashëgimisë kulturore,
- Rritja ekonomike bazuar në turizmin kulturor (specifikisht turizmin e trashëgimisë kulturore),
- Krijimi i mekanizmave alternativë për decentralizimin e vendimmarrjes në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Programi i Pjesëmarrjes Qytetare

EC Ma Ndryshe angazhohet për ndryshimin e kulturës politike të shoqërisë kosovare, përmes ndryshimit të qasjes së qytetarit ndaj autoritetit shtetëror. Ky transformim mund të arrihet përmes fuqizimit të rolit të qytetarëve në procese vendimmarrëse. Konkretisht, EC Ma Ndryshe angazhohet për krijimin dhe avansimin e mekanizmave ligjorë të pjesëmarrjes, rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës institucionale në vendimmarrje dhe tejkalimin e barrierave psikologjike të shoqërisë në raport me

autoritetet shtetërore. Niveli lokal i angazhimit për aktivizëm qytetar i jep organizatës një përparësi të theksuar veprimi, dhe rrjedhimisht mundësi më të mëdha në arritjen e rezultateve dhe ndryshimeve konkrete.

Linjat programore të komponentës së pjesëmarrjes qytetare në EC Ma Ndryshe janë:

- konsultimet publike,
- standardet ligjore dhe institucionale,
- mekanizmat e demokracisë së drejtpërdrejtë,
- buxhetimi me pjesëmarrje,
- transparenca komunale,
- politikat kulturore (dhe trashëgimia kulturore), dhe
- aktivizmi qytetar.

EC Ma Ndryshe ka përcaktuar këto objektiva afat-mesme të veprimit të saj në pjesëmarrjen qytetare në komunën e Prizrenit:

- Miratimi i të gjitha akteve ligjore rreth pjesëmarrjes qytetare nga Kuvendi Komunal i Prizrenit,
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e konsultimeve publike,
- Intensifikimi i përdorimit të mekanizmave të demokracisë së drejtpërdrejtë,
- Rritja e nivelit të trasparencës komunale në raport me vendimmarrjen dhe implementimin e politikave,
- Krijimi i mekanizmave alternativë për decentralizimin e vendimmarrjes në fushën e kulturës.

PROJEKTET

Gjatë vitit 2013 EC Ma Ndryshe ka realizuar shtatë projekte. Disa nga projektet kanë vazhduar nga viti 2013, ndërsa disa të tjera do të vazhdojnë të zbatohen edhe gjatë vitit 2014. Projektet e organizatës gjatë vitit 2013 kanë patur këtë shtrirje gjeografike brenda Kosovës: Prizren, Mamushë, Malishevë, Suharekë, Dragash, Rahovec, Gjilan dhe Prishtinë.

Transparenca Online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës

Qëllimi i projektit "Transparenca Online..." është të kontribuojë në forcimin e qeverisjes së mirë në komunën e Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës, duke krijuar mekanizma që do të kontribuojnë në rritjen e transparencës së degëve përkatëse ekzekutive. Ndërsa, objektivat specifike përfshijnë: ngritjen e nivelit të informimit publik mbi vendim-marrjen lokale; inicimin e mekanizmave qeveritare dhe gjyqësore për adresimin e keqpërdorimeve (shkelja e ligjeve dhe procedurave); rritjen e nivelit të transparencës në vendimmarrjen lokale; rritjen e vigjilencës së vendimmarrësve lokalë në lidhje me ligjshmërinë në qeverisjen vendore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grupeve të komunitetit në vendimmarrje lokale.

Aktivitetet Kryesore

Për implementimin e këtyre objektivave të projektit, EC Ma Ndryshe realizon këto aktivitete:

- Monitorimi i rregullt i degëve ekzekutive të komunave,
- Adresimi i keqpërdorimeve nga qeveritë lokale, të identifikuar gjatë monitorimit, përmes parashtrimit të evidencave, raporteve, ankesave, rasteve dhe kërkesave në qeverinë qendrore apo në institucionet gjyqësore
- Publikimi i raporteve të rregullta mbi trendet e përgjithshme të transparencës së qeverive lokale,
- Ofrimi i mbështetjes së drejtpërdrejtë për grupet lokale të komunitetit.

Të arriturat

Disa nga synimet themelore të projektit janë: aktivizimi i qeverisë qendrore dhe mekanizmave gjyqësorë, hapja e procesit të vendimmarrjes të qeverisë lokale, mobilizimi i komunitetit, adresimi i parregullsive në qeverisjen lokale, informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me vendimet e qeverisë lokale etj. Në kuadër të këtij projekti, EC Ma Ndryshe ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me kryetarët e komunave përkatëse. Deri tani në kuadër të këtij projekti janë publikuar 5 analiza të cilat përmbajnë të dhëna nga monitorimi i vazhdueshëm i ekzekutivit të komunave, si dhe 37 komunikata për shtyp për çështje dhe parregullsi të ndryshme të cilat janë paraqitur gjatë kohës së monitorimit. Projekti mbështetet financiarisht nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren

Projekti tenton të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë: gratë (amvise, nëna, gra të punësuar, OJQ-të që merren me të drejtat e gruas, nënat e vetmuara, strehimoret), pleqtë (pensionerët, shoqatat e pensionistëve), të rinjtë (nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, OJQ-të e të rinjve, studentët, shoqatat studentore, shoqatat sportive, të rinjtë të papunë, të rinjtë të punësuar, prindërit, personeli i shkollës), personat me nevoja të veçanta (personat me nevoja të veçanta [fëmijë, të rinjë, pleq], anëtarët e familjes, OJQ-të që punojnë me njerëzit me nevoja të veçanta, profesionistët mjekësorë, shkollat speciale), banorët e lagjeve të varfëra, (zyrat komunale lokale, OJQ-të humanitare, Qendra për ndihmë sociale, Qendra për Punësim, të pastrehët), kultura dhe trashëgimia

kulturore (artistët, aktivistë të OJQ-ve kulturore, kultura, zejtarët, profesionistë të trashëgimisë kulturore, planifikuesit urban, arkitektët, institucionet publike kulturore, hulumtuesit, kolonist të Qendrës Historike) dhe mjedisi (ambientalistët, OJQ-të mjedisore, institucionet publike të mjedisit, planifikuesit urban, arkitektët, hulumtuesit, komuniteti)

Aktivitetet Kryesore

Aktivitetet kryesore të projektit përmes të cilave do të implementohen objektivat e projektit janë:

- Informimi publik,
- Fokus Grupe (identifikimi i nevojave),
- Fokus Grupe (punëtori vizionuese),
- Debate,
- Raporte (raportete e hulumtimeve të kryera në kuadër të projektit),
- Hulumtimi mbi gjendjen ekzistuese urbanistike në Komunën e Prizrenit si dhe identifikimin e nevojave të qytetarëve,
- Avokim,
- Institucionalizimi i metodologjisë së pjesëmarrjes,
- Dokumentimi dhe
- Konferenca Vjetore.

Të arriturat

Deri tani janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin e parë të implementimit të këtij projekti. Gjatë vitit 2013 janë realizuar 28 fokus grupeve me 7 grupe të komunitetit, debate me 7 grupe të komunitetit, nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me qeverinë lokale (Departamenti i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor), dy hulumtime (anketime) me 500 respondentë si dhe analizat përkatëse mbi planifikimin urban me pjesëmarrje. Paralelisht me këto aktivitete, EC Ma Ndryshe ka avokuar për nevojat dhe kërkesat e grupeve të ndryshme të komunitetit, dhe si rezultat, janë shtruar disa pjerrina për pesonat me karrocë, është bërë rregullimi dhe ndërimi i disa shtyllave elektrike nga KEDS-i në lagjen Arbana të Prizrenit, si dhe janë vendosur shportat për hudhjen e mbeturinave në rrugën për në Kalanë e qytetit. Ky projekt përkrahet nga SIDA Olof Palme International Center që përkrahet nga Qeveria e Suedisë.

Rritja e pjesëmarrjes në vendimarrje përmes mediave sociale në Prizren dhe Gjilan

Projekti i mediave sociale është përpjekje për t'i inkurajuar të rinjtë e qytetit të Prizrenit dhe Gjilanit për pjesëmarrje në proceset e vendimarrjes lokale dhe përmes qasjes inovative dhe edukative, si dhe për t'ju lehtësuar atyre të kuptuarit sa më mirë të të drejtave dhe përgjegjësi qytetare. Për më tepër, projekti synon që të ngjushtojë hendekun në mes qeverisë lokale dhe të rinjve duke i mbështetur ata përmes aktiviteteve të ndryshme në terren dhe në komunitet, duke përdorur mediat sociale që janë në dispozicion gjithnjë e më shumë. Objektivat specifike të këtij projekti janë: a) të forcoj partneritetin dhe ndërveprimin midis të rinjve dhe pushtetit, përmes komunikimit interaktiv dhe të drejtpërdrejtë midis të dyja palëve, b) të rinjtë të kuptojnë më mirë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre qytetare duke përdorur dhe zhvilluar mediat sociale, me synimin afatgjatë të rritjes së pjesëmarrjes së tyre në vendimarrje dhe procesin politik të monitorimit të qeverisjes lokale dhe c) të rris interesimin e publikut dhe të kuptuarit më të mirë të të drejtave dhe përgjegjësi qytetare.

Aktivitetet Kryesore

Aktivitetet të cilat do të mundësojnë implementimin e objektivave të synuara nga projekti janë:

- Monitorimi i departamenteve të rinisë,

- Avokimi për përfshirje të rinisë në vendimmarrje,
- Takimet e të rinjëve me zyrtarët komunal,
- Prodhimi i web portalit,
- Krijimi i moduleve online për buxhetim me pjesëmarrje, shprehjen e shqetësimeve dhe peticion online/elektronik,
- Debate në shkolla dhe Universitete,
- Hulumtime mbi aktivizmin e rinisë
- SMS Platforma për informim
- Angazhim direkt i rinisë në projekt
- Dokumentar mbi "Aktivizmin Rinor në Prizren dhe Gjilan",
- Kampanjë mediale dhe informim publik, dhe
- Prodhimi i aplikacionit të mediave sociale për telefona të mençur (smart phone).

Të arriturat

Deri tani është zhvilluar web platforma me tri module online dhe SMS platforma. Tri modulet online janë: e-peticioni, ku qytetarët mund të krijojnë peticione online për çfarëdo çështje që ata i brengos, buxhetimi me pjesëmarrje, ku qytetarët mund të japin propozimet për investime kapitale që ata mendojnë se janë të nevojshme të realizohen në komunën e tyre si dhe moduli ankohu, ku qytetarët mund të raportojnë ankesat e tyre në lidhje me problemet, dukuritë dhe shqetësimet në qytet, lagje, komunitet, shkollë, park etj.

Publikimi i analizës "Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar?", ka nxjerrë në pah njohuritë e të rinjëve të Prizrenit dhe Gjilanit për hartimin e politikave lokale, procesin e vendimmarrjes, pjesëmarrjen si dhe përdorimin e mediave sociale. Debatet në shkolla të mesme, të larta dhe Universitete publike e private, kanë për qëllim informimin dhe përfshirjen e të rinjëve drejtëpërdrejtë në këtë projekt dhe në proces të vendimmarrjes lokale. Faqja e projektit në Facebook përmban të gjitha informacionet dhe aktivitetet e projektit, dhe është një prej mjeteve të rëndësishme të interakcionit midis të gjithë përfituesve të projektit. Ky projekt përkrahet nga UNDP zyra në Kosovë, ndërsa në komunën e Gjilanit zbatohet përmes partnerit lokal, Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të vlerësoj trashëgiminë kulturore dhe të shfrytëzojë potencialin e saj për zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Prizrenit. Objektivat specifike të projektit përfshijnë: a) Mobilizimin e komunitetit të trashëgimisë kulturore dhe të angazhoj ata në mënyrë efektive në mbrojtjen dhe promovimin e saj, b) Të lehtësojë dialogun në mes të shoqërisë civile (dhe komunitetit në përgjithësi) dhe qeverisë lokale në shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore për qëllime zhvillimore, c) Të promovojë qasje të integruar të ruajtjes së trashëgimisë kulturore si një metodologji efektive për zhvillimin lokal, d) Të nxisë ndjenjën e pronësisë dhe përgjegjësisë përmes veprimeve lokale të trashëgimisë kulturore, e) Të ngrit ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e trashëgimisë kulturore, dhe f) Të dokumentojë vlerat e trashëgimisë kulturore të rajonit, si një mjet më të mirë të prezantimit dhe promovimit të këtij potenciali.

Aktivitetet kryesore

Aktivitetet përmes të cilave EC Ma Ndryshe e zbaton këtë projekt janë:

- Përgatitja, asistimi dhe pjesëmarrja në takimet e Grupeve Punuese Ndër-Komunale dhe Rajonale,

- Mobilizimi i komunitetit të trashëgimisë kulturore, si dhe komunitetit në përgjithësi nëpërmjet vullnetarëve,
- Grumbullimi, analizimi dhe klasifikimi i të dhënave për zhvillimin e një Plani Rajonal të Trashëgimisë Kulturore si the Planit komunal të veprimit në përputhje me planin rajonal,
- Identifikimi i tri veprimeve të mundshme lokale që do të dorzohen në vitin 2014 me synim të promovimit të trashëgimisë kulturore
- Krijimi i Kalendarit të Trashëgimisë Kulturore 2014 për rajonin e Prizrenit,
- Asistimi në konkursin për logo të identitetit vizual të ofertës kulturore dhe trashëgimisë kulturore të rajonit,
- Organizimi i vizitave në terren për nxënës dhe grupet e komunitetit, për t'i familjarizuar ata me vlerat dhe potencialin e trashëgimisë kulturore
- Ofrimi i mbështetjes logjistike për studentët gjatë aktiviteteve adaptuese në terren,
- Organizimi i ekspozitave në shkolla në mënyrë që të rinjtë të angazhohen aktivisht në promovimin e trashëgimisë kulturore,
- Asistimi në fushatën e grumbullimit të storieve.

Të arriturat

Deri tani, në kuadër të projektit janë realizuar: futja e të dhënave të trashëgimisë kulturore të paluajshme në platformën online (inventari prej 36 monumenteve në total) për rajonin e Prizrenit, të dhënave të trashëgimisë natyrore (6 sosh), trashëgimisë së paprekshme, databaza me 870 pyetësor të dizajnuar për të zbuluar potencialin e trashëgimisë dhe pasuritë turistike të rajonit të Prizrenit, 8 vizita me shkollat fillore dhe 6 vizita me publikun e gjere (grupet e magjinalizuara). Ky projekt përkrahet nga Këshilli i Evropës, zyra në Kosovë.

Urbanism Watch “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”

Ky projekt është rezultat i punës së organizatës në monitorimin e qeverisjes lokale në Prizren dhe synon të instalojë një sistem të monitorimit permanent të aktivitetit shtetëror (në dy nivelet e qeverisjes) në fushën e menaxhimit dhe zhvillimit urban në qytetin e Prizrenit, me theks të veçantë në Qendrën Historike të tij. Përmes të të gjeturave të monitorimit, ky sistem do të plotësohet me komponentat e publikimit dhe avokimit për të siguruar rend urbanistik në Prizren. Qëllimi themelor i projektit është të pengojë degradimin e mëtejshëm urbanistik të Prizrenit dhe të ndikojë në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për zhvillim të kontrolluar dhe të qëndrueshëm urban, përmes rritjes së transparencës dhe sigurimit të llogaridhënies në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.

Aktivitetet kryesore

Për arritjen e objektivave të projektit, EC Ma Ndryshe do realizon këto aktivitete:

- Monitorimi i përhershëm i institucioneve përmes stafit monitorues që do të kenë qasje të papenguar në vendimmarrjen e këtyre institucioneve
- Publikimi i rregullt i të gjeturave të monitorimit të cilat do të publikohen në baza të rregullta përmes mekanizmave të ndryshëm
- Adresimi i përgjegjësive institucionale, ku të gjitha shkeljet e identifikuar gjatë procesit të monitorimit do të procesohen në institucionet përkatëse të adresimit të përgjegjësive,
- Avokimi i rregullt ndaj institucioneve të monitoruara do të ndërtohet mbi të gjeturat e publikuara të monitorimit
- Mobilizimi qytetar për planifikim urban ku projekti do të përfitojë nga aktiviteti i EC Ma Ndryshe që ka filluar në janar 2013 dhe i cili synon përkthimin e nevojave të grupeve të komunitetit.

Të arriturat

Që nga fillimi i implementimit të projektit, stafi i EC Ma Ndryshe ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme punën e institucioneve që janë përgjegjëse për sigurimin e rendit urbanistik në komunën e Prizrenit. Në këtë kuadër, projekti ka publikuar 5 komunikata si dhe dy analiza të shkurtra, ndërsa projekti do të vazhdojë me dinamikën e prodhimit të të gjeturave edhe gjatë vitit 2014. Ky projekt përkrahet nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS.

Rritja e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në nivel lokal

Projekti kishte për qëllim të nxisë qeverinë lokale për të parë kulturën si burim strategjik të zhvillimit, si dhe të promovojë pjesëmarrjen qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore. Forumet e debatit, hulumtimet, fushata mediale, dokumentari dhe avokimi ishin mjetet kryesore të projektit për të promovuar sistemin e decentralizuar të menaxhimit të kulturës, prioritizimin e kulturës në politika publike, shfrytëzimin e potencialit kulturor për zhvillim lokal dhe përfshirjen aktive të komunitetit të kulturës në vendimmarrjen lokale. Poashtu, qëllimi i këtij projekti ishte nxitja e debatit shoqëror për t'i promovuar vlerat dhe përfitimet e bashkëpunimit të strukturuar në mes të qeverisë lokale dhe shoqërisë civile përmes avokimit efektiv për më tepër pjesëmarrje qytetare në zhvillimin e politikave kulturore në qytetin e Prizrenit.

Aktivitetet kryesore

Në kuadër të këtij projekti janë ndërmarrë këto aktivitete:

- Hulumtimi mbi potencialin e pjesëmarrjes qytetare në zhvillim të politikave kulturore në nivel lokal në Prizren,
- Seri debatesh mbi pjesëmarrjen qytetare në zhvillimin e politikave kulturore në nivel lokal për t'i diskutuar gjetjet e hulumtimit,
- Publikimi mbi pjesëmarrjen qytetare në zhvillimin e politikave kulturore në nivel lokal, ku janë përfshirë rezultatet e hulumtimit, raportet e debateve dhe analiza politike
- Dokumentari i shkurtër mbi kulturën dhe politikat kulturore në qytetin e Prizrenit.

Te arriturat

Projekti ka arritur të nxisë debatin mbi politikat kulturore, të jap opsione të qarta politike për qeverinë lokale dhe të mobilizoj më tutje komunitetin kulturor të Prizrenit. Gjatë kohës së zbatimit të këtij projekti janë organizuar dy anketime, një me qytetarë të Prizrenit dhe një me organizatat e kulturës në Prizren dhe janë organizuar debatet me temat: Politikat kulturore lokale në Prizren, Politikat e financimit kulturor në nivel lokal, Kultura dhe trashëgimia kulturore në programin e partive politike dhe Konsumi dhe oferta kulturore në nivel lokal, të cilat janë transmetuar edhe në televizionin lokal TV Opinion. Poashtu, është realizuar një reklamë me karakter informues për financimin e aktiviteteve kulturore nga komuna e Prizrenit, si dhe dokumentari "Prizreni qytet Kulturor" ku qytetarët, artistët, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe institucioneve komunale flasin për kulturën, rëndësinë dhe vështësitë e kulturës në qytetin e Prizrenit. Ky projekt u përkrah nga Zyra Zvicerrane për Bashkëpunim në Kosovë përmes Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile.

Pakot Turistike

Qëllimi i këtij produkti është tërheqja e turistëve (nga jashtë dhe nga qytetet e tjera të Kosovës) përmes krijimit të mundësive për të kaluar kohë cilësore dhe informative në Prizren. Në të njëjtën kohë, pakot turistike do të promovojnë edhe veprimtarinë e ciceronëve, që paraqet një sektor ende të pazhvilluar të kulturës dhe turizmit në Prizren. Ndërsa objektivat specifike të projektit janë: të strukturohet dhe

prezantohet profesionalisht pasuria kulturore e Prizrenit, të tërhiqen turistët përmes ofertave konkrete për të njohur qytetin, të promovohet veprimtaria e ciceronëve, dhe të rritet numri i referencave të shkruara mbi trashëgiminë kulturore të Prizrenit

Aktivitetet dhe të arriturat

Zbatimi i projektit parasheh realizimin e pesë pakove turistike. Secila pako do të ketë broshurën e vet (të shtypur dhe të promovuar virtualisht) dhe kontakt informacionet për ciceronët përkatës. Realizimi i një pakoje turistike përfshin: përpilimin e tekstit nga profesionistët, disenjimin, përkthimin, shtypjen dhe promovimin virtual. Tematikisht, këto pesë pako turistike do të ndahen në: trashëgimia e përgjithshme e qytetit, trashëgimia arkitekturore, trashëgimia arkeologjike, trashëgimia shpirtërore dhe trashëgimia fetare. Këtë aktivitet EC Ma Ndryshe e ka realizuar në emër të Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren, ku aktualisht e koordinon Sekretariatit.

SHKURTIMISHT VITI 2013

Në pjesën vijuese janë paraqitur momentet më të rëndësishme të punës së organizatës gjatë vitit 2013, si pjesë e projekteve, iniciativave dhe aktiviteteve të tjera.

"A Balkan Tale" në Prishtinë

17 janar, 2013

Pas një sukcesi në Prizren, "A Balkan Tale" u sjellë edhe në Muzeun Kombëtar të Kosovës në Prishtinë, organizuar nga EC Ma Ndryshe. Ekspozita u hap më 17 janar 2013, në praninë e një numri të madh artdashësish, ndërsa do të jetë e hapur për publikun deri më 25 janar. Ekspozita është një punë e përbashkët ndërmjet EC Ma Ndryshe, Goethe Institut Athinë dhe partnerëve të tjerë nga shtetet e Ballkanit.

Debati "Politikat e financimit të kulturës në nivel Lokal"

25 janar, 2013

Debati "Politikat e financimit të kulturës në nivel Lokal" në kuadër të projektit "Rritja e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në nivel lokal", u mbajt më 25 janar 2013, në Restaurant Marashi (Lagjia Marash) në Prizren. Panelistë të debatit ishin: Znj. Vjollca Aliu, drejtoreshë e departamentit të Trashëgimisë Kulturore në MKRS, Z. Ruzhdi Rexha, nënkryetari i komunës së Prizrenit, Z. Sali Shoshi, drejtor i CHwB, Zyra në Prishtinë dhe Z. Bari Zenelaj, drejtor i OJQ ATTA në Prizren. Në këtë debat u trajtuan çështje të ndryshme të financimit të kulturës në përgjithsi dhe në komunën e Prizrenit në veçanti dhe u konkludua që as në nivel lokal e as në atë qendror nuk ka politika fiskale të cilat do të rregullonin mënyrën e financimit të kulturës. Poashtu, konkludim tjetër nga ky debat ishte që kultura nuk konsiderohet shtyllë e zhvillimit të vendit por barrë e këtij procesi.

Ekspozita e Vullnetarëve të Kulturës

1 shkurt, 2013

Vullnetarët të cilët ishin përfituesit direkt të projektit "Vullnetarët e Kulturës", në fazën e tretë të implementimit të aktiviteteve të projektit që ishte "Avokimi", me 1 shkurt 2013, organizuan ekspozitën me fotografi me pamje të qytetit të vjetër të Prizrenit dhe fotografi me pamje të qytetit të sotëm. Ekspozita qëndroi e hapur në 'Shadërvan' - qendër të qytetit të Prizrenit për tri ditë dhe u vizitua nga qytetarë të shumtë të Prizrenit gjatë ditëve që ishte e hapur.

Debati "Konsumi dhe oferta kulturore në Prizren"

4 mars, 2013

Debati "Konsumi dhe oferta kulturore në Prizren" në kuadër të projektit "Rritja e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në nivel lokal", u mbajt më 4 mars 2013 në Restaurant Marashi (Lagjia Marash) në Prizren. Panelistë të debatit ishin: Z. Zekë Çeku, ekspert i turizmit, Z. Urim Ukimeri, koordinator i kulturës në komunën e Prizrenit, Z. Veton Nurkollari, Dokufest dhe Besar Haxhibeqiri, koordinator i Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren - RrOK. Në debat u diskutua për potencialin turistik dhe kulturor që e ka komuna e Prizrenit e poashtu edhe për neglizhiencën e treguar nga institucionet lokale për ta promovuar këtë potencial. Konkludim nga debati ishte sa tashmë është koha e fundit kur potenciali turistik e kulturor i Prizrenit duhet të shihen dhe trajtohen si shtyllat kryesore të zhvillimit të qytetit.

Vizitë studimore në Bruksel

19-22 mars, 2013

EC Ma Ndryshe morri pjesë në vizitën studimore "Demokracia e drejtpërdrejtë dhe e-demokracia si mjet për promovimin e transparencës, angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes". Programi P2Pu ofroi mundësi OJQ-ve të vizitojnë institucionet e BE-së, si dhe organizatat relevante platformë të BE-së, në mënyrë që të familjarizohen me strukturat e BE-së, procesin e politikë, programet, politikat dhe praktikat më të mira. Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte për të dhënë pjesëmarrësve mundësinë të njihen me politikat e BE-së dhe programet që lidhen me angazhimin qytetar dhe transparencën, si dhe për të ofruar atyre shkëmbimin dhe mundësitë e rrjeteve midis tyre dhe me organizata të tjera të shoqërisë civile aktive në këtë fushë në nivel evropian. Shembuj kombëtarë dhe rajonal të veprimeve në këtë fushë u prezantuan për pjesëmarrësit dhe nga pjesëmarrësit.

Prezantohet analiza "Gabim pas Gabimi"*20 mars, 2013*

EC Ma Ndryshe në bashkëpunim me Forumin 2015 organizoi tryezën e diskutimit "Gabim pas Gabimi" për të diskutuar mbi situatën aktuale në trashëgimi kulturore dhe identifikuar veprime konkrete për tejkalimin e sfidave në këtë sektor. Në këtë tryezë u prezantua analiza e radhës e serisë së Forumit 2015 "Çka shkoj ters", e përgatitur nga EC Ma Ndryshe dhe e titulluar "Gabim pas gabimi".

Diskutimi publik me temën "Çfarë na pret në zgjedhjet e ardhshme?"*27 mars, 2013*

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në bashkëpunim me organizatën EC Ma Ndryshe në Prizren, më 27 mars organizuan tryezën e diskutimit me temën "Çfarë na pret në zgjedhjet e ardhshme?" Të ftuar në këtë tryezë ishin përfaqësues të partive politike, zyrtarë të lartë komunal, shoqëria civile, qytetarët e Prizrenit dhe akterë tjerë relevant. Në këtë tryezë u diskutua për hapat e deritashëm në lidhje me reformën zgjedhore dhe u elaboruan ndryshimet e mundshme në ligjin zgjedhor.

Debati "Kultura në programin e partive politike në Prizren"*3 prill, 2013*

Debati "Kultura në programin e partive politike në Prizren" në kuadër të projektit "Rritja e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në nivel lokal", u mbajt më 3 prill 2013 në Restaurant Marashi (Lagjia Marash) në Prizren. Panelistë të debatit ishin: Arjeta Nezaj - LDK, Arbër Rexhaj - VV dhe Mensur Bytyqi - AAK. Në këtë debat u diskutua për kulturën në programet e partive politike e poashtu u dhanë sugjerime nga pjesëmarrës tjerë nga fusha e kulturës si dhe qytetarët e Prizrenit. Si konkludim, përveç Lëvizjes Vetëvendosje që dukej se kishte një vizion pak më të qartë në lidhje me zhvillimin e kulturës në komunën e Prizrenit, asnjëri subjekt tjetër politik nuk kishte ndonjë plan të zhvillimit të aspektit kulturor në këtë komunë.

Reagim në lidhje me emërimin e tre anëtarëve të parë të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore*22 prill, 2012*

Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren ka reaguar për emërimin e tre anëtarëve të parë të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore në Prizren duke njoftuar publikun se personat e emëruar në Këshillin e Trashëgimisë Kulturore nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit si përfaqësues të shoqërisë civile, nuk e përfaqësojnë vullnetin e RrOK-ut dhe të anëtarëve të tij.

Takimi vjetor i rrjetit SEE Heritage*27 – 28 prill, 2013*

Takimi vjetor, i njëmbëdhjeti me rradhë i rrjetit SEE Heritage u mbajt në Kotor të Malit të Zi. Takimi u përcjell me konferencën "Trashëgimia rurale e Europës Juglindore", në të cilën morën pjesë përfaqësues nga të gjitha vendet anëtare të rrjetit, dhe disa organizata prezantuan projektet dhe punën e tyre në lidhje me temën e konferencës. Gajtë takimit u diskutua për punën e rrjetit gjatë një viti si dhe anëtarët e rrjetit prezentuan punën e tyre që nga takimi i fundit.

Tryeza e diskutimit "Degradimi natyror dhe urbanistik i Prizrenit"*2 maj, 2013*

EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit", organizoi tryezën e diskutimit "Degradimi natyror dhe urbanistik i Prizrenit" më 2 maj 2013 në Restaurant Marashi (Lagjia Marash) në Prizren. Panelistë të tryezës ishin: Z. Ian Cliff, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Z. Ruzhdi Rexha, Nën-kryetar i komunës së Prizrenit, Z. Fisnik Minci, gazetar i Koha Ditore dhe Z. Naim Cahanaj nga Instituti Demokratik i Kosovës. Gjatë tryezës u publikua analiza e radhës e projektit mbi temën e degradimit natyror dhe urban në Prizren.

Kalendari kulturor dhe turistik i Prizrenit 2013

Prill, 2013

Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren – RrOK, publikoi kalendarin kulturor dhe turistik të Prizrenit për vitin 2013. Kalendarin kulturor dhe turistik të Prizrenit ka për qëllim të promovojë rrjetëzimin e organizatave që kanë aktivitetet kulturore dhe turistike, të strukturojë ofertën turistike të qytetit përmes futjes së të gjitha aktiviteteve kulturore turistike në kalendarin kulturor (turistik) të Prizrenit..

Ndërpriten aktivitetet ndërtuese në Prevallë

3 maj, 2013

Si rezultat i punës avokuese të EC Ma Ndryshe rreth degradimit urbanistik të Prevallës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marrë vendim që të ndërpriten të gjitha aktivitetet ndërtimore në zonën e Prevallës deri në afat të pacaktuar. Këtë vendim, ministri i MMPH-së, Dardan Gashi e ka marrë pas degradimit të mjedisit, gjegjësisht tejkalimit të kushteve dhe kriterëve për ndërtim dhe mosrespektimin e udhëzuesit të MMPH-së që ju ka dërguar Komunës së Prizrenit për mënyrën e zbatimit të planit urban për këtë zonë.

Memorandumi në mes të EC Ma Ndryshe dhe Komunës së Mamushës

13 maj, 2013

Më 13 maj, në zyrën e Kryetarit të Komunës së Mamushës, EC Ma Ndryshe nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Kryetarin e Komunës, Arif Butuç, për monitorimin e ekzekutivit lokal në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Mamushës". Memorandumi i Mirëkuptimit precizon zotimet e palëve nënshkruese për realizim sa më efektiv të projektit "Transparenca online e Komunës së Mamushës", i cili që nga muaji maj do të zbatohet me ndihmën financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar.

EC Ma Ndryshe në konferencën për demokracinë lokale

15 maj, 2013

EC Ma Ndryshe morri pjesë në konferencën ndërkombëtare "Demokracia lokale - Përmirësimi i bashkëpunimit në mes të Qeverisë Lokale dhe Shoqërisë Civile", për të prezantuar bashkëpunimin e saj me qeverinë lokale në Prizren. Kjo konferencë u organizua nga TACSO Kosova në bashkëpunim me zyrat e tjera të TACSO-s në rajon. Pjesëmarrës në konferencë ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile nga shtetet fqinjë si Mali i Zi, Bosna dhe Hercegovina, Maqedonia si dhe nga Turqia, me ç'rast i ndanë përvojat e tyre të bashkëpunimit me qeveritë lokale në qytetet përkatëse.

Publikohet studimi mbi politikat kulturore lokale në Prizren

31 maj, 2013

Konferenca "Politikat kulturore lokale në Prizren" në kuadër të projektit "Rritja e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në nivel lokal", u mbajt më 31 maj 2013 në Hotel Theranda në Prizren. Panelistë të debatit ishin: Z. Ruzhdi Rexha, nënkryetar i komunës së Prizrenit, Z. Almir Sahiti, drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në komunën e Prizrenit, Z. Samir Hoxha, drejtor i Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në komunën e Prizrenit, Z. Aliriza Arënliu, bartës i hulumtimit dhe Z. Valon Xhabali nga OJQ EC Ma Ndryshe. Në këtë debat u prezantuan produktet finale të projektit njëvjeçar: filmi i shkurtër dokumentar mbi mungesën e politikave kulturore lokale në komunën e Prizrenit si dhe hulumtimi i bërë me qytetarët dhe organizatat kulturore në Prizren. Ky projekt u përkrah nga Zyra Zvicerrane për Bashkëpunim dhe Fondacioni Kosovarë i Shoqërisë Civile.

Shtrimi i pjerrinave në qytetin e Prizrenit

3 qershor, 2013

Në bazë të nevojave dhe shqetësimeve të nxjerrura nga fokus grupet me persona me nevoja të veçanta, në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" dhe me iniciativën dhe shtysën e vazhdueshëm nga ana e EC Ma Ndryshe, më 3 qershor 2013 u bë shtrimi i 2 pjerrinave në qytetin e Prizrenit.

Lansohet web faqja "Pjesëmarrja përmes mediave sociale"

Qershor 2013

EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit "Rritja e pjesëmarrjes përmes mediave sociale", lansoi web faqen e këtij projekti. Projekti ka për qëllim të inkurajoj të rinjtë e Prizrenit dhe Gjilani që përmes qasjes inovative dhe edukative t'ia mundësoj kuptimin e të drejtave të tyre qytetare dhe përgjegjësi. Projekti poashtu synon të ngushtojë hendekun mes pushtetit lokal dhe të rinjëve duke mbështetur të rinjtë përmes aktiviteteve të ndryshme në terren dhe komunitet. Kjo platformë ofron tre module të medias sociale për pjesëmarrja aktive: buxhetimi me pjesëmarrje, ankohu dhe peticioni elektronik.

Vizita studimore në Çeki

10 – 15 qershor, 2015

EC Ma Ndryshe si përfituese e projektit "Ndërtimi i Partneriteteve për Veprim Lokal", ishte pjesëmarrëse në vizitën studimore në disa qytete të Republikës Çeke. Ky projekt është iniciativë e përbashkët e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Europeum – European Institute for Policy, i cili synon iniciimin e projekteve të përbashkëta lokale mes organizatave të shoqërisë civile në Kosovë dhe Republikës së Çekisë.

Vizita studimore në Beograd

13 – 16 qershor, 2013

EC Ma Ndryshe, si organizatë partnere e Olof Palme International Center ishte pjesëmarrëse në vizitën studimore në Beograd, e cila kishte për qëllim njohjen me punën e të rinjëve në Serbi. Synimi i kësaj vizite ishte që organizatat partnere të Olof Palmes të cilat kanë në fokus të punës së tyre punën me të rinjtë, të marrin përvoja të reja nga ligjeratat dhe vizitat në qendrat për të rinjtë. Temat e shtjelluara gjatë kësaj vizite ishin: politikat publike për të rinjtë, mbështetja e iniciativave të të rinjëve nga Qendrat Burimore, njohja e profesionit të punës me të rinjtë dhe sigurimi i cilësisë, kontributi i OJQ-ve në zhvillimin e politikave rinore, sigurimi i hapësirave publike për të rinjtë si edhe bashkëpunimi i të rinjëve me autoritetet publike.

"A Balkan Tale" në Mitrovicë

19 qershor, 2013

Pas shfaqjes me sukses në Hamamin "Gazi Mehmet Pasha" të Prizrenit dhe në Muzeun Kombëtar të Kosovës në Prishtinë, ekspozita "A Balkan Tale" u dërgua edhe në Mitrovicë me iniciativën e "EC Ma Ndryshe". Ekspozita u hap më 19 qershor 2013, në praninë e një numri të madh artdashësish, dhe do të jetë e hapur për publikun deri më 26 qershor. Ekspozita është një punë e përbashkët ndërmjet EC Ma Ndryshe, Goethe Institut Athinë dhe partnerëve të tjerë nga shtetet e Ballkanit.

Seminari "Supozimet për zhvillim të qëndrueshëm"

29 qershor – 1 korrik, 2013

EC Ma Ndryshe morri pjesë në seminarin "Supozimet për zhvillim të qëndrueshëm" i organizuar në kuadër të projektit "Rrjetëzimi lokal për zhvillim të qëndrueshëm", i cili implementohet nga: Fondi i Beogradit për përsosmëri politike në bashkëpunim me Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur nga Prishtina. Qëllimi i këtij projekti është të përmirësojë bashkëpunimin në nivel lokal ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, të japë kontribut drejt zhvillimit të dialogut demokratik lidhur me çështjet e rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm, të japë kontribut drejt ndërtimit të kapaciteteve njerëzore përmes ngritjes së vetëdijes dhe fitimit të njohurive të reja të personave nga vetëqeverisja lokale, organizatat e shoqërisë civile në bashkësitë lokale, përfaqësuesve të komunitetit akademik dhe biznesor, si dhe të inicojë dhe zhvillojë komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet vendimmarrësve të bashkësive lokale në Serbi dhe Kosovë.

Shkolla verore mbi bashkëpunimin rajonal në Budapest

7 – 14 korrik, 2013

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të organizatës, një staf i EC Ma Ndryshe mori pjesë në shkollën verore mbi bashkëpunimin rajonal me temën "Fqinjët e Vjetër - Politikat e reja në vendet përgjatë Danubit dhe Rajonit të Detit të Zi", që u mbajt në Budapest, Hungari. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj shkolle është krijimi i një rrjeti të shkencëtarëve të rinj që merren me çështjen e bashkëpunimit rajonal, si perspektivë e Evropës Qendrore.

Vendosja e shtyllave të reja elektrike në lagjen "Arbana" të Prizrenit

10 korrik, 2013

Në bazë të nevojave dhe shqetësimeve të nxjerrura nga fokus grupet me lagje të varfëra gjegjësisht lagjia "Arbana", në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" dhe me iniciativën dhe shtytjen e vazhdueshëm nga ana e EC Ma Ndryshe drejtuar KEDS-it, më 10 korrik 2013 filloi implementimi për kontrollimin, rregullimin dhe vendosjen e shtyllave të reja elektrike në lagjen "Arbana". Ky është rezultat i punës së këtij projekti me banorët e lagjes Arbana.

EC Ma Ndryshe në konferencën e OSBE për qeverisjen lokale

16 korrik, 2013

EC Ma Ndryshe morri pjesë në "Konferencën për shkëmbimin e praktikave më të mira rajonale për angazhimin e qytetarëve në çështjet e qeverisjes lokale" e organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Në këtë konferencë përfaqësuesja e EC Ma Ndryshe prezantoi përvojën e organizatës në fushën e monitorimit të Komunës së Prizrenit dhe Mamushës në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe Mamushës". Në konferencë morrën pjesë edhe përfaqësues të OSHC-ve nga shtetet e rajonit si: Maqedonia, Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi të cilët poashtu ndanë përvojat e tyre të bashkëpunimit me qeveritë lokale. Në konferencë u konkludua se mbikqyrja e ekzekutivit dhe legjislativit nga shoqëria civile është shumë me rëndësi për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve komunale.

Vendosja e shportave të mbeturinave në rrugën e Kalasë në Prizren

3 gusht, 2013

Si plotësim i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, të nxjerrura nga fokus grupet me ambientalistë, gra dhe të rinj në kuadër të pjesës avokuese të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren", më 3 gusht 2013 u bë vendosja e shportave të mbeturinave rrugës për në Kalanë e qytetit.

Peticion kundër degradimit të qytetit të Prizrenit

12 gusht, 2013

EC Ma Ndryshe dhe Dokufest kanë nisur iniciativën qytetare për të ndaluar degradimin e mëtejshëm urban të qytetit të Prizrenit. Peticioni ka për qëllim të adresoj problemin e zhvillimit të pakontrolluar urban në komunën e Prizrenit dhe i dedikohet kryetarit të ardhshëm të komunës së Prizrenit, i cili pritet të marrë detyrën në Dhjetor të këtij viti. Kjo iniciativë për mbledhjen e nënshkrimeve të qytetarëve të Prizrenit në kuadër të këtij peticioni është shpalosur përmes konferencës për media.

Debati "Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar?"

13 shtator, 2013

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrje përmes mediave sociale në Prizren dhe Gjilan" ka publikuar analizën e titulluar "Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar?" Analiza shqyrton transparencën e komunave të Prizrenit dhe të Gjilanit në raport me të rinjtë që jetojnë në këto dy qendra urbane. Të gjeturat e këtij raporti burojnë nga hulumtimi respektivisht anketimi i të rinjve të shkollave të mesme dhe të universiteteve të Prizrenit dhe Gjilanit. Në anketë janë përfshirë 200 të rinj nga secila komunë që i janë përgjigjur pyetjeve në lidhje me funksionimin e pushtetit lokal, transparencën dhe përfshirjen e publikut dhe të rinjve në vendimmarrjen komunale.

Debati "Gratë dhe planifikimi urban në Prizren"

20 shtator, 2013

EC Ma Ndryshe nis ciklin e debateve "Planifikim urban me pjesëmarrje". Qëllimi i këtyre debateve është prezantimi i të gjeturave të 28 fokus grupeve me shtatë grupe të komunitetit në Prizren për identifikimin e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve në raport me planifikimin urban. Debatet do të jenë forume të avokimit publik ndaj qeverisë lokale, ku pjesëmarrës do të jenë përfaqësues të grupit përkatës të komunitetit, komunës, shoqërisë civile, medias, qeverisë qendrore dhe ekspertë të planifikimit urban. Ky cikël i shtatë debateve realizohet në kuadër të projektit "Qyteti Gjithëpërfshirës" që përkrahët nga Olof Palme International Center, e cila mbështetet nga Qeveria e Suedisë.

Debati i parë i këtij cikli "Gratë dhe planifikimi urban në Prizren" u mbajt me 20 shtator, 2013 në Restaurant Marashi - Prizren. Panelistë të këtij debati ishin z. Sadik Paqarizi - Drejtor i DUPH dhe znj. Merita Halitaj - One To One Kosova. Përveq prezentimit të analizës "Planifikim urban për qytetarët", u diskutuan edhe shumë brenga dhe shqetësime të komunitetit të gruas nga panelistët dhe kontribues të shumtë. Debatet e këtij lloji kontribuojnë si në nxjerrjen e nevojave të qytetarëve dhe adresimin e tyre tek DUPH por edhe në koordinimin dhe avokimin për qytetarët dhe komunën.

Debati "Të rinjtë dhe planifikimi urban në Prizren"

25 shtator, 2013

"Të rinjtë dhe planifikimi urban në Prizren" është debati i dytë nga cikli i debateve në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren". Në këtë debat të mbajtur më 25 shtator 2013, përveq prezentimit të kërkesave të të rinjve të dalura nga fokus gupet u bë dhe prezentimi i analizës "Planifikim urban për qytetarët" (paraqitja e rezultateve të dalura nga anketimi me të rinj). Diskutimi me panelistë dhe me pjesëmarrës të shumtë ishte frytdhënës për nga ana e nxjerrjes së rekomandimeve të ndryshme të cilat do të përfshihen në raportin i cili do t'i dërgohet Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për përfshirje në Planet Urbane që ata hartojnë.

Prezentimi kulturor i Prizrenit në Sllovaki

25 – 29 shtator, 2013

Si pjesë e përpjekjeve të diplomacisë publike dhe kulturore të Kosovës, EC Ma Ndryshe prezantoi një program kulturor tre ditor në Sllovaki. Programi ka përfshirë prezentimin mbi ofertën kulturore dhe turistike të qytetit të Prizrenit, trashëgiminë kulturore dhe natyrore si dhe performancën artistike. Qëllimi i kësaj vizite poashtu ishte inicimi i një shkëmbimi të qëndrueshëm kulturor në mes të dy vendeve.

Debati "Personat me nevoja të veqanta dhe planifikimi urban në Prizren"

2 tetor, 2013

"Personat me nevoja të veqanta dhe planifikimi urban në Prizren" është debati i tretë nga cikli i debateve në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren". Në këtë debat të mbajtur më 2 tetor 2013, në Prizren, panelistë ishin: Z. Refki Muzbegu - koordinator në DUPH dhe Znj. Fjolla Duraku - Qendra burimore "Lef Nosi"-Prizren (FFAK). Gjatë debatit u bë prezentimi i kërkesave, shqetësimeve dhe nevojave të nxjerrura nga fokus grupet dhe paraqitja e analizës "Planifikimi urban për qytetarët" (paraqitja e rezultateve të dalura nga pjesa hulumtuese e projektit).

Kandidatët për kryetar të Komunës së Prizrenit përballë rinisë

4 tetor, 2013

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes përmes medieve sociale, ka organizuar takim të parë jo-formal me kandidatët për Kryetar të Komunës së Prizrenit në zgjedhjet lokale të 3 nëntorit 2013. Duke synuar që të rinjtë e Prizrenit të informohen paraprakisht me idetë dhe planet e secilit kandidat, takimi u mbajt në një ambient jo-formal ku diskutimet ishin të drejtpërdrejta dhe të hapura. Në këtë debat prezantimi i programeve për rininë u bë nga kandidatët: Z. Arbër Rexhaj - Vetëvendosje, Z. Fadil Softa - Alternativa Demokratike e Kosovës, Z. Lulzim Kabashi - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës / Lidhja Demokratike e Dardanisë, Z. Naser Bresa - Aleanca Kosova e Re, Z. Zafir Berisha - Bashkimi Demokratik.

Seminari "Roli i pushteteve lokale në mbrojtjen e resurseve natyrore"

4 – 6 tetor, 2013

EC Ma Ndryshe morri pjesë në seminarin "Roli i pushteteve lokale në mbrojtjen e resurseve natyrore", seminari i dytë në kuadër të projektit "Rrjetëzimi lokal për zhvillim të qëndrueshëm", i cili implementohet nga: Fondi i Beogradit për përsosmëri politike në bashkëpunim me Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur nga Prishtina. Qëllimi i këtij projekti është të përmirësojë bashkëpunimin në nivel lokal ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, të japë kontribut drejt zhvillimit të dialogut demokratik lidhur me çështjet e rëndësishme për zhvillim të qëndrueshëm, të japë kontribut drejt ndërtimit të kapaciteteve njerëzore përmes ngritjes së vetëdijes dhe fitimit të njohurive të reja të personave nga vetëqeverisja lokale, organizatat e shoqërisë civile në bashkësitë lokale, përfaqësuesve të

komunitetit akademik dhe biznesor, si dhe të inicojë dhe zhvillojë komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet vendimmarrësve të bashkësive lokale në Serbi dhe Kosovë.

Konferenca vjetore e projektit "Transparenca Online e Komunës së Prizrenit"

8 tetor, 2013

EC Ma Ndryshe ka organizuar konferencën vjetore të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe Mamushës", ku panelistë ishin Z. Ian Cliff, ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë dhe Z. Ruzhdi Rexha, nënkryetar i komunës së Prizrenit. Gjatë konferencës është publikuar analiza "Një vit monitorim për më shumë transparencë" që përmbledh punën një vjeçare të organizatës në këtë projekt.

Debati "Të moshuarit dhe planifikimi urban në Prizren"

9 tetor, 2013

"Të moshuarit dhe planifikimi urban në Prizren" është debati i katërt me rradhë që u mbajt në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren". Panelistë të debatit ishin: Z. Hysamedin Gjergjizi - Sekretarë në Organizatën e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës dhe Z. Ramadan Tafallari - Drejtorja e Shërbimeve Publike-DSHP. Edhe në këtë debat u bë prezantimi i kërkesave të pensionerëve dhe analizës së projektit. Të pranishëm ishin përfaqësues nga DUPH, DSHP, Organizata e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, Shoqatës së Veteranëve të Arsimit, Komiteti PAF, Fonia dhe komuniteti i pensionerëve si dhe Z. Shaban Kajtazi - Kryetar i Lidhjes së Pensionerëve të Kosovës.

Debati "Kandidatët për kryetar të Komunës së Prizrenit përballë rinisë"

10 tetor, 2013

EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendim-marrjes përmes medieve sociale, organizoi takimin e dytë jo-formal me kandidatët për Kryetar të Komunës së Prizrenit në zgjedhjet lokale të 3 nëntorit 2013. Duke synuar që të rinjtë e Prizrenit të informohen paraprakisht me idetë dhe planet e secilit kandidat, takimi u mbajt në një ambient jo-formal ku ishin të mundura diskutime të drejtpërdrejta dhe të hapura. Prezantimi i programeve për rininë u bë nga këta kandidatë: Z. Beni Kizolli – Partia Konservatore, Z. Eqrem Kryeziu – Lidhja Demokratike e Kosovës, Z. Fadil Kryeziu – Nisma Qytetare për Prizrenin dhe Z. Pajtim Kosova – Partia e Drejtësisë.

Tryezë diskutimi mbi drejtësinë në zgjedhjet e 3 nëntorit

11 tetor, 2013

Instituti i Kosovës për Drejtësi, në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit dhe organizatën EC Ma Ndryshe, organizuan tryezën me titull "Drejtësia në zgjedhjet e 3 nëntorit". Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues të të gjithë akterëve të institucioneve të drejtësisë të nivelit qendror dhe lokal, kandidatë të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe mediave. Qëllimi i mbajtjes së kësaj tryeze ishte senzibilizimi i të gjithë akterëve, partive politike dhe opinionit të gjerë, rreth gatishmërisë së institucioneve të drejtësisë për të luftuar çdo veprim në drejtim të manipulimit të votave në zgjedhjet e 3 nëntorit 2013.

Debati "Banorët e lagjaës Arbana dhe planifikimi urban në Prizren"

16 tetor, 2013

Debati i pestë në vazhden e ciklit të debateve të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" ishte debati "Banorët e lagjes Arbana dhe planifikimi urban në Prizren". Panelistët e debatit ishin: Z. Ekrem Kryeziu - punonjës në QMF - Arbanë dhe Znj. Shpresa Osmanollaj - DUPH. Prej të pranishmëve përveç banorëve të lagjes Arbana ishin dhe drejtori i Hidroregjionit Jugor Z. Besim Baraliu dhe Z. Arjanit Ukimeri nga ky institucion, përfaqësues nga DUPH dhe DSHP, të pranishëm nga OJQ të ndryshme, policia e Kosovës, SH.H. Pashtriku, B&S Europe, OSBE, etj.

Debati "Kultura dhe planifikimi urban në Prizren"

23 tetor, 2013

Debati i gjashtë nga cikli i debateve të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" ishte debati "Kultura dhe planifikimi urban në Prizren". Panelistët e debatit ishin: Z. Veton Nurkollari (Drejtor artistik i Doku Fest-it) dhe Leutrim Fishekqiu (Drejtor ekzekutiv i Sculp

Fest-it). Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit nga nga DUPH dhe DSHP, DokuFest, Sculp Fest, KDI, UN Habitat, SH.Z.A.P, Kompleksi kulturor "Europa", Sh.B. Sharri, OJQ "Finch", OJQ FFAK, OSBE - Prizren, AKEA, etj. Në debat u diskutua për shumë çështje kulturore të cilat ndërlidhen me urbanizmin direkt ose indirekt, në të njëjtën kohë u propozuan edhe zgjedhje të problemeve që u identifikuan nga të pranishmit.

Debati "Mjedisi dhe planifikimi urban në Prizren"

30 tetor, 2013

Cikli i debateve të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS - Planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" u përmbyll më 30 tetor, 2013 me debatin "Mjedisi dhe planifikimi urban në Prizren". Panelistë të debatit ishin: Z. Ramadan Tafallari - DSHP dhe Z. Osman Krasniqi - Drejtor në Q.A.M "Pellgu". Temat që u diskutuan në debat kishin të bënin me ambientin në tërësi e veqanërisht me qështjen se si të bëhet përmirësimi i gjendjes aktuale të lumit Lumbardh.

Tryezë diskutimi "Kush mbikëqyr mbikëqyrësit"

12 nëntor, 2013

Forumi 2015 organizoi tryezën e diskutimit për të publikuar studimin "Kush mbikëqyr mbikëqyrësit?" të përgaditur nga OJQ EC Ma Ndryshe. Në këtë studim janë analizuar elementet kryesore që e përcaktojnë llogaridhënien e shoqërisë civile, bazuar në parimet dhe praktikant univverzale të cilat janë shfrytëzuar si bazë për të analizuar gjendjen e llogaridhënies së sektorit civil në Kosovë.

Ecjet Historike

Edhe gjatë vitit 2013, EC Ma Ndryshe ka vazhduar të organizoj "Ecjet Historike" për grupe të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në shoqërimin e Ciceronit. Qëllimi i këtij aktiviteti të organizuar në mënyrë të vazhdueshme nga EC Ma Ndryshe, është të njoftoj grupet e ndryshme me monumentet e trashëgimisë kulturore në Prizren.

Vizitat Hajde

Në kuadër të projektit "Trashëgimia kulturore, shtylla qendrore e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren", janë realizuar 8 vizita me nxënësit e shkollave fillore dhe 6 vizita me publikun e gjerë (grupet e magjinalizuara).

Personat me nevoja të veçanta dhe hartëzimi i pengesave

8 dhjetor, 2013

Në Prizren është realizuar ecja e personave me nevoja të veçanta për identifikimin e pengesave fizike, duke filluar nga rrethrotullimi në lagjen Bazhdarhane (afër memorialit të NATO-s) deri në sheshin Shadërvan. Pas identifikimit të këtyre pengesave, do të përgaditet harta e pengesave, e cila do t'i dërgohet qeverisë lokale të Prizrenit me kërkesën për veprime konkrete në eliminimin e këtyre pengesave.

Konferenca "Rritja e pjesëmarrjes në vendimarrjen komunale"

13 dhjetor, 2013

Në konferencën "Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjen komunale" të organizuar nga UNDP dhe EC Ma Ndryshe, u lansua video dokumentari "Prizren: Pyt...?". Video dokumentari paraqet qytetarët të cilët përmes një video kabine kanë bërë pyetje lidhur me çështjet të cilat i preokupojnë në komunën e tyre dhe përgjigjet e zyrtarëve komunal për këta qytetarë. Poashtu u lansua animacioni "Ku shkojnë paratë tona?" përmes të cilit synohet të prezantohet si krijohet dhe si harxhohet buxheti komunal.

Aksion kundër bllokimit të trotuareve

13 dhjetor, 2013

EC Ma Ndryshe në bashkëpunim me të rinjtë e shkollave të mesme të Prizrenit ka zhvilluar një aksion kundër bllokimit të trotuareve para shkollave. Pas aksionit rrugor, organizata do të dërgojë kërkesën e këtyre rinjve për zhblokim të trotuareve para shkollave, institucioneve përgjegjëse. Aksioni u ndërmarr si pjesë e veprimeve avokuese të projektit "Qyteti Gjithëpërfshirës...", ku bllokimi i trotuareve është evidentuar si një nga shqetësimet kryesore të qytetarëve të Prizrenit.

PUBLIKIMET

Gjatë vitit 2013, organizata ka prodhuar dhjetë publikime, përfshi analiza, dokumente të politikave, raporte, studime hulumtuese dhe video produkte.

Qyteti gjithëpërfshirës

Dhjetor, 2013

Publikimi është përmbledhje e shtatë raporteve të shkruara nga ekspertët e fushave përkatëse, të cilët kanë qenë të angazhuar për t'i shndërruar të gjeturat e fokus grupeve, debateve dhe anketimeve me shtatë grupe të komunitetit gjatë vitit 2013 në dokumente ekzekutive që do t'i shërbejnë qeverisë lokale të Prizrenit në hartimin e planeve urbane.

Planifikim urban për qytetarët 2

Dhjetor, 2013

Ky është raporti i dytë i serisë së anketimeve dhe hulumtimeve, i hartuar duke u bazuar në rezultatet e anketimit të realizuar me qytetarët e Prizrenit për çështjet urbanistike në Prizren, në kuadër të projektit "Qyteti Gjithëpërfshirës...". Raporti bazohet në anketimin e realizuar gjatë pjesës së dytë të vitit 2013 dhe shpalos nevojat dhe brengat e qytetarëve të Prizrenit dhe grupeve specifike të komunitetit sa i përket urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në qytet.

Kush mbikëqyr mbikëqyrësit? – Llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë

Nëntor, 2013

Studimi synon të ofrojë një përmbledhje të elementeve kryesore që e përcaktojnë llogaridhënien e shoqërisë civile, bazuar në parimet dhe praktikat univerzale të cilat janë shfrytëzuar si bazë për të analizuar gjendjen e llogaridhënies së sektorit civil në Kosovë. Duke qenë i pari i këtij lloji në Kosovë, ky studim mbledh në një vend parimet kryesore dhe zbatimin e tyre në Kosovë, me qëllim të ofrimit të një baze informatash dhe njohurishë për të hapur një debat konstruktiv rreth kësaj çështje.

Një vit monitorim për më shumë transparencë

Tetor, 2013

Raporti përfshin punën njëvjeçare të organizatës në monitorimin e transparencës së komunës së Prizrenit dhe punën disa mujore në monitorimin e transparencës së komunës së Mamushës. Kjo analizë është përgatitur në kuadër të projektit "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" dhe përfshin të gjeturat që lidhen me dikastere të ndryshme të këtyre qeverive lokale, me një theks të veçantë në transparencë dhe përpjekjet për përmirësimin e kësaj fushe të rëndësishme të qeverisjes lokale si parakusht për një demokraci të qëndrueshme.

Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar?

Shtator, 2013

Kjo analizë shqyrton transparencën e komunave të Prizrenit dhe Gjilanit në raport me të rinjtë që jetojnë në këto dy qendra urbane. Të gjeturat e këtij raporti burojnë nga hulumtimi me të rinjtë e shkollave të mesme dhe të universiteteve në Prizren dhe Gjilan.

Planifikim urban për qytetarët

Shtator, 2013

Ky raport i hartuar duke u bazuar në rezultatet e anketimit të realizuar me qytetarët e Prizrenit për çështjet urbanistike në këtë komunë, në kuadër të projektit "Qyteti Gjithëpërfshirës...", shpalos nevojat dhe brengat e qytetarëve sa i përket urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në këtë komunë.

Politikat kulturore dhe Qyteti

Maj, 2013

Studimi përfshin raportin e hulumtimit të realizuar me 500 respondentë të qytetit të Prizrenit, rezultatet e 23 intervistave të strukturuar me organizata të përfshira në aktivitete kulturore në Prizren dhe përmbledhjen e katër diskutimeve të organizuara me aktorë relevantë në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Ky studim poashtu tenton t'i jap udhëzimet themelore për zhvillimin e politikave kulturore në qytet, duke u bazuar në të dhënat dhe rezultatet e këtij hulumtimi.

Prizreni "Qytet i kulturës" (film dokumentar)

Maj, 2013

Filmi dokumentar u realizua në kuadër të projektit "Rritja e pjesëmarrjes qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në nivel lokal". Ky film dokumentar pasqyron potencialin kulturor që ka qyteti i Prizrenit si dhe promovon kulturën si një prej shtyllave kryesore të zhvillimit lokal përmes politikave kulturore dhe planifikimit.

Degradimi natyror dhe urbanistik

Maj, 2013

Raporti përmban brenda vetes punën katër mujore (dhjetor 2012 dhe janar, shkurt e mars 2013) të monitorimit të ekzekutivit lokal në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit". Kjo analizë ndonëse përfshin zhvillimet në dikastere të ndryshme të qeverisë komunale të Prizrenit, një përqendrim të veçantë i'a kushton aktualitetit urbanistik në Prevallë, me një vështrim retroaktiv edhe në ndërtimin e pakontrolluar brenda qytetit dhe në Qendrën Historike.

Gabim pas Gabimi – Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimin kulturore

Mars, 2013

Kjo analizë e shkurtër adreson (mos)veprimet institucionale në dekadën e fundit në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Të gjitha problemet e trashëgimisë kulturore në këtë analië janë analizuar përmes disa momenteve dhe ngjarjeve kyçe si: urbanizimi turbo-kaotik, politizimi i trashëgimisë kulturore, statusi politik dhe UNESCO, marsi 2004, zonat e veçanta të mbrojtura, ndikimi i misioneve ndërkombëtare, plani kombëtar dhe politikat e trashëgimisë kulturore, mungesa e inventarit shtetëror, intervenimet e vonuara emergjente dhe shkatërrimi i Qendrës Historike të Prizrenit. Analiza është përgaditur nga EC Ma Ndryshe për Forumin 2015.

RRJETËZIMI

Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren (RrOK Prizren), është rrjet joformal i organizatave të kulturës në komunën e Prizrenit. Misioni i këtij Rrjeti është arritja e një ekonomie të zhvilluar lokale në Prizren përmes pasurimit dhe strukturimit të ofertës turistike bazuar në rritjen e cilësisë dhe vëllimit të aktiviteteve kulturore. Momentalisht, EC Ma Ndryshe kordinon sekretariatit e Rrjetit përmes të cilit në bashkëpunim me organizatat tjera anëtarë, është i angazhuar në një dialog të strukturuar me qeverinë lokale të Prizrenit për të nxitur zhvillimin e politikave lokale kulturore.

Paralelisht me punën e saj në politikat lokale kulturore, EC Ma Ndryshe është njëra nga themelueset e **Forumit Kulturor** (Rrjeti i organizatave të pavarura kulturore të Kosovës), i cili promovon politikat kulturore në nivelin qendror. Aktiviteti konkret i Forumit Kulturor është avokimi për Strategjinë Shtetërore Kulturore të Kosovës, si një dokument udhërrëfyes për zhvillimin e politikave kulturore.

EC Ma Ndryshe është anëtare dhe njëra nga themelueset e rrjetit më të fuqishëm rajonal të trashëgimisë kulturore **South East European Heritage Network**. Anëtare të këtij rrjeti janë organizatat më të fuqishme të shteteve të Ballkanit që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është aktive në projekte të bashkëpunimit rajonal, të cilat kanë lindur nga veprimtaria e rrjetit dhe bashkëpunon me një numër të madh organizatash rajonale.

EC Ma Ndryshe poashtu është themeluese e **Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit**, ku përfaqësohen të gjitha organizatat dhe institucionet kulturore të Prizrenit. Forumi ka krijuar një platformë bashkëpunimi jo vetëm mes OJQ-ve të qytetit, por edhe mes sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, duke shërbyer si mjet efikas për adresimin e çështjeve të ndieshme të qytetit.

Gjithashtu, EC Ma Ndryshe është anëtare e **Platformës Civikos**, rrjetit më të madh të organizatave jo-qeveritare që janë të angazhuara në dialogun mes sektorit të shoqërisë civile dhe qeverisë.

DONATORËT

Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë së EC Ma Ndryshe përkrahet nga institucionet dhe organizatat donatore. Ndihma e tyre është mjaft e rëndësishme në qëndrueshmërinë institucionale të organizatës dhe në përmbushjen e misionit të saj.

Donatorët që na kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të na ndihmojnë:

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)

Trashëgimia Kulturore pa Kufij, zyra në Prishtinë (CHWB Prishtina)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

Komisioni Evropian

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K)

Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë

Olof Palme International Center (OPIC)

Rockefeller Brothers Fund (RBF)


United Nations Development Program Kosova (UNDP)

British Council, zyra në Prishtinë


Këshilli i Evropës, zyra në Kosovë

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, zyra në Prishtinë (YIHR)

Raporti vjetor i punës për vitin 2013 u miratua në takimin vjetor të Kuvendit të Anëtarëve të EC Ma Ndryshe, mbajtur më 20 dhjetor 2013, në Prizren


Në emër të Kuvendit të Anëtarëve
Enver Batiu, kryesues i Kuvendit të Anëtarëve




Në emër të stafit të organizatës
Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv